

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS KONTRATA

Komuna e Fushë Kosovës – Adresa: Rr. "Tahir Zemaj" nr.2 Fushë Kosovë (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;
dhe

Shpk "VISCO" Adresa: Rr. Ramadan Berisha nr.30 – Fushë Kosovë me numër unik identifikues 810135378 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), përfaqësuar nga Visar Berisha - drejtor në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punët e shënuara me poshtë:

Titulli: **"Asfaltimi i rrugës Meshari (krah) në Fushë Kosovë"**

Numri i Prokurimit : **612 20 6750 536**

Numri i brendshëm: **612 20 091 536**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: *Asfaltimi i rrugës Meshari – krah në gjatësi 190m dhe gjerësi 4m sipas specifikave në dosjen e tenderit.*

1.2 Kontrata hynë në fuqi nga data e nënshkrimit dhe përfundon pas 10 ditë pune.
ditë pune.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 2 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: *Rruga Meshari – krah në Fushë Kosovë.*

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP1 (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **7 817.00 €**;

Me fjalë: Shtatë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimi të tërë dërgesës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *punëve* duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimi të *punëve*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të

barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërrprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërrprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	VISAR BERISHA	Emri:	Bedri Obërtinca
Pozita:	DREJTOR	Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	12.11.2020	Data:	12.11.2020
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA
e punëve për asfaltimin e Rr. "Meshari" në Fushë Kosovë

Gjatësi : 190 m', b = 4 m'

Nr.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	çmimi /njësi	shuma €
A PUNËT PARAPRAKE					
1	Pastrimi i terrenit nga objektet egzistuese dhe largimi i materialit .	m ²	190	0.5	95
2	Inqizimi gjeodezik i trupit të rrugës , bartja e koordinatave nga zyra e kadastrit në teren .	m'	190	0.5	95

Gjithësejt : 190.00

B. PUNËT E DHEUT					
1	Mihja e dheut me makinë në gjerësi prej 4 m' dhe thellësi 25 cm, ngarkimi dhe transporti deri në depëni të cilën e cakton organi mbikqyrës në largësi deri 5 km.	m ³	190	0.5	95
2	Rrafshimi dhe nivelizimi i nënbazës me makinë me saktësi deri 3 cm, ngjeshja me cilindër vibrues dhe kompaktësimi i nënbazës, Ms= 300 kg/cm2	m ²	760	0.3	228

Gjithësejt : 323.00

C OBJEKTET					
1	Furnizimi , transporti dhe punimi i bankinave nga materiali rrethor, guror, rrafshimi i bankinave, ngjeshja e nënbazës, prurja e materialit rrethor-guror, shpërndarja dhe ngjeshja me trashësi prej 12 cm.	m ²	190	2	380
2	Ngritja e pusëve në nivelin e rrugës	copë	8	20	160

Gjithësejt : 540.00

D SHITESA QARKULLUESE					
1	Furnizimi transporti dhe punimi i shtresës së tamponit me material guror me granulacion 0-60 mm, si shtresë e parë me trashësi t= 20 cm dhe kompaktësim Ms= 400 kg/cm2.	m ³	152	4	608
2	Furnizimi transporti dhe punimi i shtresës së tamponit me material guror me granulacion 0-31,5 mm, me trashësi t= 15 cm dhe kompaktësim Ms= 400 kg/cm2. Në llogari të përfshihet edhe shqyrtimi gjeo mekanik .	m ³	114	4	456
3	Furnizimi transporti dhe punimi i shtresës së asfalt-betonit (AB16), furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja me trashësi prej t=7cm, në gjendje të ngjeshur,	m ²	760	7.5	5700

Gjithësejt : 6,764.00

RIKAPITULLIMI

A	PUNËT PARAPRAKE	190.00
B	PUNËT E DHEUT	323.00
C	OBJEKTET	540.00
D	SHITESA QARKULLUESE	6,764.00

TOTAL 7,817.00 €.

Qershori 2020

Fushë Kosovë

Përgatiti : Drejtorati për PU



**PLANI DINAMIK: Asfaltimi i rrugës Meshari (krah) në Fushë
Kosovë**

Poz.	Përshkrimi i aktiviteteve	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	PUNET PARAPRAKE										
2	PUNET E DHEUT										
3	OBJEKTET										
4	SHTRESA QARKULLESE										

Verejtje: Plani dinamik është parapar për 10 dite pune.



EMËRTIMI I MENAXHERIT TE PROJEKTIT

“Visco” Sh.p.k. e përfaqësuar nga z. **Visar Berisha**—Drejtör

Emërton menaxherin e projektit në fjalë ing. Dipl. Ndërt. **Agim Gjoshi**

Titulli i ptojektit: Asfaltimi i rrugës Meshari (krah) në Fushë Kosovë

Nr. I Prokurimit: 612-20-6750-5-3-6

Nr. I Brenshem: 612 20 091 536

(dokumentat e tij :CV,Diploma ,kontrata e punës si dhe dokumentacioni përkatës gjinden në dosjen e bashkangjitur,).

Ingjinieri I lartëpermendur do të udhëheqë punimet sipas projektit dhe kontratës së mundshme në emër të Kompanisë

“Visco” Sh.p.k.

Visar Berisha



Më datën 02.11.2020